

## **SKEDE INFORMIMI - THIRRJE E HAPUR PËR APLIKIME PILOT MBI HAPËSIRËN E TË DHËNAVE PËR KOMUNITETET E ZGJUARA (Raundi 2)**

Data Spaces for Smart and Sustainable Cities and Communities (DS4SSCC) është një projekt i formuar nga një konsorcium prej 7 entiteve nga 6 vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe synimi i tij është mbi krijimin e veprimave përgatitore për një hapësirë të të dhënave për qytete dhe komunitete të qëndrueshme dhe të zgjuara.

### **1. Synimi i thirrjes:**

Synimi i thirrjes për pilotët është të validohet në praktikë një hapësirë të të dhënave ndërsektoriale në nivel të BE-së dhe të përmirësohet kjo hapësirë për të mbështetur prioritetet e politikave të qyteteve dhe komuniteteve brenda Bashkimit Evropian, përfshirë transformimin e gjelbër-dixhital.

### **2. Kush mund të aplikojë:**

Konsorciumet e pranueshme duhet të përbëhen nga të paktën dy administrata publike lokale ose rajonale nga shtete të ndryshme anëtare të BE-së dhe/ose vende të lidhura me Programin e BE-së Digital Europe, të cilat promovojnë bashkëpunimin ndërsektorial dhe merren me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Ato administrata lokale duhet të alokojnë fond në buxhetin e tyre për bashkifinancimin e projektit pilot dhe të dërgojnë një Letër Angazhimi. Administratat lokale mund të përfshijnë gjithashtu palë të tjera të pranueshme që punojnë me to (p.sh., kompanitë, akademitë, OJQ-të). Shqipëria është vend pjesëmarrës në Programin e BE-së Digital Europe. Preferohet që partneri kryesor të jetë një administratë publike lokale ose rajonale në Shtetet Anëtare të BE-së.

### **3. Çfarë partneriteti favorizohet:**

Favorizohen partneritetet ndërmjet administratave lokale nga shtete të ndryshme anëtare të BE-së dhe vendet e tjera të lidhura, për të promovuar bashkëpunimin ndërsektorial që përmbush objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.

### **4. Cili është buxheti i thirrjes dhe për projekt:**

Kontributi i përgjithshëm i BE-së për pilotët është 15.300.000 EUR, i cili do të shpërndahet ndërmjet 10-12 konsorciume të përzgjedhura. Granti maksimal për projekt është 1.500.000 euro për pilot dhe maksimumi 1.000.000 euro për entitet.

Aplikantët duhet të kontribuojnë me të paktën **50% të kostove të projektit si bashkëfinancim**.

### **6. Fushat e veprimit të thirrjes:**

- Menaxhimi i parashikueshëm i trafikut dhe planifikimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme
- Shërbimet e të dhënave të lidhura me motin dhe ngjarjet klimatike
- Menaxhimi i flukseve të energjisë në një kontekst specifik të qytetit/komunitetit
- Veprimet për ndotje zero (ajri, uji, toka, mbetjet)
- Fusha të tjera të nismës së Re të Bauhaus-it Evropian ((dizajn urban, menaxhimi i ndërtesave, shërbimet publike, zgjidhjet e bazuara në natyrë, ndër të tjera)

### **6. Si bëhet aplikimi:**

Aplikimet dorëzohen përmes një platforme për menaxhimin e thirrjeve për Pilota, ku konsorciumet duhet të plotësojnë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të dorëzojnë një ide të pilotit që do të zbatohet në përputhje me udhëzimet e përcaktuara.

### **7. Kur është afati i fundit:**

Afati i fundit për aplikime për raundin e dytë është 30 nëntor 2024.

### **8. Linku i thirrjes:**

<https://www.ds4sscc.eu/cfp-two>